



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 935/Prot.
3

Tiranë, më 28.6 /2017

Lënda : *Opinion në lidhje me kërkesën për bërjen publike nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të dosjeve profesionale të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*

Drejtuar: **Z. Alban BRATI**

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar Z. Brati,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Zyra e Komisionerit") u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 935/1 prot, datë 23.06.2017 dhe me rrethanat e parashtruara në të. Ripërmendim me këtë rast vlerësimin tonë lidhur me ndërgjegjësimin gjithnjë në rritje të shoqërisë civile për të qenë të informuar dhe për të kërkuar transparencë lidhur me procese me interes të lartë publik si ai i reformës në drejtësi.

Referuar dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. 1732 prot., datë 19.06.2017 nga organizata Lex Ferenda në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji për të Drejtën e Informimit"), Zyra e Komisionerit vlerëson se eksperiencia profesionale e anëtarëve të institucioneve që do të kryejnë vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është thelbësore për garantimin e një procesi rivlerësimi të drejtë dhe të paanshëm sikurse është edhe pritshmëria e publikut nga ky proces.

Sa i përket informacionit që përmbajnë dosjet e secilit anëtar, vetë Neni A i Aneksit të Kushtetutës, duke pasur parasysh impaktin dhe interesin e lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi, përcakton se kryerja e procesit të rivlerësimit, i cili përbën thelbin e kësaj reforme, imponon disa kufizime të të drejtave themelore të parashikuara në Kushtetutë, pjesë e të cilave është edhe respektimi i të drejtës së privatësisë.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumentacioni i kërkuar nga organizata Lex Ferenda përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe për pasojë duhet të vihet në dispozicion kërkuarit.

Siç mund të vërehet edhe në opinionet e mëparshme të dhëna për Avokatin e Popullit apo Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Zyra e Komisionerit, që në fillim të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për organet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i ka kushtuar rëndësi të veçantë transparencës në këtë proces, duke e vlerësuar si një qasje të domosdoshme nga secili institucion i përfshirë, me qëllim garantimin e një rezultati përfundimtar në përputhje me pritshmëritë e publikut nga kjo reformë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
